

Dhikri i Mëngjesit – Shejkh Abdur-Razzak el-Bedër

Burimi: Kitabudh-dhikri ued-du'aai

Duaja (1)

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ لَا يَضُرُّ مَعَ اسْمِهِ شَيْءٌ فِي الْأَرْضِ وَلَا فِي السَّمَاوَاتِ وَهُوَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ

Bismil-Lahil-ledhii la jedurru me'a ismiHi shej-un fil-erdi ue la fis-semaai, ue Hues-Semii'ul-'Alim. ([tre herë](#))

“Kërkoj ndihmë dhe mbrojtje me Emrin e Allahut, me përmendjen e të Cilit nuk të dëmton asgjë në tokë dhe nuk të godet asnë bela që zurret nga qielli! Dhe Ai është Dëgjuesi i fjalëve tona dhe i Gjithëdituri i çështjeve tona!” ¹

Duaja (2)

يَا حَمْدُكَ يَا قَيْوُمُ بِرَحْمَتِكَ أَسْتَغْيِثُ أَصْلَحْ لِي شَأْنِي كُلَّهُ وَلَا تَكِلْنِي إِلَى نَفْسِي طَرْفَةً عَيْنٍ

Ja Hajju ja Kajjuum biRahmetiKe estegiith, aslih lii she'nije kul-lehu, ue la tekilnii ila nefsii tarfete 'ajn.

“O i Gjalli i përhershëm, o i Vetëmjaftueshëm (Mbikëqyrës)! Kërkoj ndihmë me Mëshirën tënde, ma përmirëso gjithë gjendjen time, dhe mos më lër t'i mbështetem vetes sime as sa një përpëlitje syri!” ²

¹ Transmeton 'Uthman ibn 'Affan – RadijAllahu anhu – se i Dërguari i Allahut – sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem – ka thënë: “Çdokush që thotë në mëngjesin dhe mbrëmjen çdo dite: “Kërkoj ndihmë dhe mbrojtje me Emrin e Allahut me përmendjen e të Cilit nuk të dëmton asgjë në tokë dhe nuk të godet asnë bela që zurret nga qielli! Dhe Ai është Dëgjuesi i fjalëve tona dhe i Gjithëdituri i çështjeve tona”, **nuk do ta dëmtojë atë asgjë.**” [Transmeton Tirmidhiu, 3388]

² Transmeton Enes ibn Malik – RadijAllahu 'anhu –, i cili thotë: “I Dërguari i Allahut – sal-lAllahu 'alejhi ue sel-lem – i tha Fatimes – RadijAllahu 'anha –: “Çfarë të pengon ty, që të veprosh diçka me të cilën të këshilloj; të thuash në sabah dhe në mbrëmje: “O i Gjalli i Përhershëm, o i Vetëmjaftueshëm (Mbikëqyrës)! Kërkoj ndihmë me Mëshirën

Duaja (3)

سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ

SubhanAllahi ue bihamdiHi

(100 herë)

“I Pastër nga çdo mangësi është Allahu dhe Atij i takon Lavdia.”³

Duaja (4)

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ هُوَ اللَّهُ أَحَدٌ ﴿١﴾ إِنَّ اللَّهَ الصَّمَدُ ﴿٢﴾ لَمْ يَلِدْ وَلَمْ يُوْلَدْ ﴿٣﴾ لَمْ يَكُنْ لَّهُ كُفُواً أَحَدٌ ﴿٤﴾

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit.

“Thuaj (o Muhamed)! Ai është Allahu, Ai është Një dhe i Vetëm (Nuk ka të barabartë me Të, as ndihmues, as të ngjashëm me Të)! Allahu është Es-Samed (Atij i drejtohen kriesat për nevojat e tyre, Ai është i Vetëmjaftueshëm (Mbikëqyrës, i Gjallë i Përherershëm)! Ai as nuk ka lindur kënd, dhe as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë dhe i krahasueshëm me Të.” (tre herë)

tënde, ma përmirëso gjithë gjendjen time, dhe mos më lër t'i mbështetem vetes sime as sa një përpëlitje syri!”⁴
[Transmeton Nesaiu në Sunen el-Kubra, 10330]

³ Transmeton Ebu Hurejrah – RadijAllahu ‘anhu – se i Dërguari i Allahut – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – ka thënë: “Kush thotë njëqind herë në mengjes dhe në mbrëmje “I Pastër nga çdo mangësi është Allahu dhe Atij i takon Lavdia”, nuk do të vijë asnjë në Ditën e Gjykimit me diçka më të mirë se kjo që ka bërë ky, përveç dikujt që ka thënë aq sa ka thënë ai, apo më tepër se ai.” [Transmeton Muslimi, 2692]

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ الْفَلَقِ ﴿١﴾ مِنْ شَرِّ مَا خَلَقَ ﴿٢﴾ وَمِنْ شَرِّ غَاسِقٍ إِذَا وَقَبَ ﴿٣﴾ وَمِنْ شَرِّ
النَّفَاثَاتِ فِي الْعُقَدِ ﴿٤﴾ وَمِنْ شَرِّ حَاسِدٍ إِذَا حَسَدَ ﴿٥﴾

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit.

“Thuaj! Kërkoj mbrojtjen e Zotit të agimit! Nga e keqja e të gjitha krijesave (Xhehenemit, Iblisit dhe pasuesve të tij)! Dhe nga e keqja e errësirës së natës, kur ajo bie! Dhe nga e keqja e magjistarëve, që lidhin dhe fryjnë nyja! Dhe nga e keqja e smirëkeqit kur ka zili!” (tre herë)

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

قُلْ أَعُوذُ بِرَبِّ النَّاسِ ﴿١﴾ مَلِكِ النَّاسِ ﴿٢﴾ إِلَهِ النَّاسِ ﴿٣﴾ مِنْ شَرِّ الْوَسْوَاسِ الْخَنَّاسِ ﴿٤﴾
الَّذِي يُوَسْوِسُ فِي صُدُورِ النَّاسِ ﴿٥﴾ مِنَ الْجِنَّةِ وَالنَّاسِ ﴿٦﴾

Me Emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit.

“Thuaj! Kërkoj mbrojtjen e Zotit të njerëzve! Sunduesit të njerëzve! Të Adhuruarit të njerëzve! Prej të keqes së atij (shejtanit) që pëshpërit (të keqen në zemrat e njerëzve), i cili fshihet (kur dikush e përmend Allahun). I cili hedh vesvese në zemrat e njerëzve! (Qoftë ai që vepron këtë) prej Xhinëve apo prej njerëzve!” (tre herë)⁴

⁴ Transmeton Abdullah ibn Khubejb, i cili thotë: “Dolëm në një natë shumë të errët me shi, të kërkonim të Dërguarin e Allahut – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – që të na printe në namaz. Pasi e arrita atë, më tha: “Thuaj diçka!” Ndërsa unë nuk thash asgjë! Pastaj më tha përsëri: “Thuaj diçka!”, dhe unë nuk thash përsëri asgjë. Ai më tha përsëri: “Thuaj diçka!”, atëherë unë i thash: “Çfarë të them?!” Ai tha: “Thuaj: “Kul Hua Allahu Ehad” dhe dy Suret e kërkimit të mbrojtjes (Kul e’uudhu biRabbil-felek, dhe Kul e’uudhu biRabbin-nas) në mbrëmje dhe në mëngjes tre herë, dhe do të të mjaftojnë ty për çdo gjë!”” [Transmeton Ebu Daudi, 5082 dhe Tirmidhiu, 3575]

Duaja (5)

اللَّهُمَّ أَنْتَ رَبِّي لَا إِلَهَ إِلَّا أَنْتَ، خَلَقْتَنِي وَأَنَا عَبْدُكَ، وَأَنَا عَلَى عَهْدِكَ وَوَعْدِكَ مَا اسْتَطَعْتُ، أَعُوذُ
بِكَ مِنْ شَرِّ مَا صَنَعْتُ، أَبُوءُ لَكَ بِنِعْمَتِكَ عَلَيَّ، وَأَبُوءُ بِذَنِّي فَاغْفِرْ لِي فَإِنَّهُ لَا يَغْفِرُ الذُّنُوبَ إِلَّا
أَنْتَ

Allahumme Ente Rabbii, la ilahe il-la Ente. Khalektenii, ue ene 'abduKe, ue ene 'ala 'ahdiKe ue u'adiKe mas-tet'atu. E'uudhu biKe min sherri ma san'atu. Ebuu-u leKe bi ni'ametiKe 'alejje, ue ebuu-u bi dhenbii, fe-gfir lii, fe innehu la jegfirudh-dhunuube il-la Ente.

“O Allah! Ti je Zoti im, nuk ka tē adhuruar tjetér me tē drejtē pérveç Teje! Ti më ke krijuar mua, dhe unë jam robi Yt! Unë do tē jem besnik ndaj marrëveshjes dhe premtimit tim që kam ndaj Teje, aq sa tē mundem! Kërkoj mbrojtjen Tënde prej tē keqes që kam bërë! Ty tē jam mirënlohës pér tē mirat që mi ke dhënë! Unë i pranoj mëkatet e mia, prandaj më fal mua, pasi askush nuk mund t'i fal mëkatet pérveç Teje!” ⁵

Duaja (6)

أَصْبَحْنَا وَأَصْبَحَ الْمُلْكُ لِلَّهِ، وَالْحَمْدُ لِلَّهِ. لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ
وَهُوَ عَلَى كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ. رَبُّ أَسْأَلُكَ خَيْرَ مَا فِي هَذَا الْيَوْمِ وَخَيْرَ مَا بَعْدَهُ، وَأَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ
مَا فِي هَذَا الْيَوْمِ وَشَرِّ مَا بَعْدَهُ، رَبُّ أَعُوذُ بِكَ مِنَ الْكَسَلِ وَسُوءِ الْكَبَرِ، رَبُّ أَعُوذُ بِكَ مِنْ عَذَابٍ
فِي النَّارِ وَعَذَابٍ فِي الْقَبْرِ

⁵ Transmeton Shedad ibn Eus – RadijAllahu ‘anhu – se Pejgamberi – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – ka thënë: “**Zoteria i Istigfareve (kërkimit të faljes) eshtë tē thuash:** “O Allah! Ti je Zoti im, nuk ka tē adhuruar tjetér me tē drejtē pérveç Teje! Ti më ke krijuar mua, dhe unë jam robi Yt! Unë do qëndroj besnik ndaj marrëveshjes dhe premtimit tim që kam ndaj Teje, sa tē mundem! Kërkoj mbrojtjen Tënde prej tē keqes që kam bërë! Ty tē jam mirënlohës pér tē mirat që mi ke dhënë! Unë i pranoj mëkatet e mia, prandaj më fal mua, pasi askush nuk mund t'i fal mëkatet pérveç Teje!” **Kush e thotë këtë në sabah, duke qenë i bindur në tē, dhe vdes po atë ditë pa ardhur mbrëmja, do tē jetë prej banorëve tē Xhennetit. Dhe kush e thotë këtë në mbrëmje, me bindje në tē, dhe vdes pa ardhur mëngjesi, do tē jetë prej banorëve tē Xhennetit.**” [Transmeton Bukhari, 6306]

Asbahna ue asbahal-mulku lil-Lah, uel hamdu li-Lah. La ilahe il-Allahu uahdeHu la sherike leH, leHul-mulku ue leHul-hamdu ue Hue ‘ala kul-li shej-in kadiir. Rabbi es-eluke khajra ma fii hadhal-jeumi ue khajra ma b’adehu, ue e’uudhu biKe min sherri ma fii hadhal-jeumi ue sherri me b’adehu. Rabbi e’uudhu biKe minel-keseli ue suuil-kiber, Rabbi e’uudhu biKe min ‘adhabin fin-nari ue ‘adhabin fil-kabr.

“E arrit  m m  ngjesin, i gjith   sundimi dhe e gjith   lavdia i takojn   Allahut! Nuk ka t   adhuruar tjet  r me t   drejt   p  rvec Allahut, t   Vet  m dhe t   Pashok. Atij i takon Sundimi dhe Lavdia dhe Ai   sht   Plotfuqish  m p  r   do gj  . O Zoti im! T   k  rkoj Ty t   mir  n e asaj q   gjendet n   k  t   dit  , dhe t   mir  n e dit  ve n   vazhdim! Dhe k  rkoj mbrojtjen T  nde prej t   keqes q   gjendet n   k  t   dit  , dhe t   keqes s   dit  ve n   vazhdim! O Zoti im! K  rkoj mbrojtjen T  nde prej p  rtacis   dhe nga e keqja e pleq  ris  ! O Zoti im! K  rkoj mbrojtjen T  nde prej d  nimit t   Zjarrit dhe prej d  nimit t   varrit!”⁶

Duaja (7)

اللَّهُمَّ إِنِّي أَصْبَحْنَا، وَبِكَ أَمْسَيْنَا، وَبِكَ نَحْيَا، وَبِكَ نُمُوتُ وَإِلَيْكَ النُّشُورُ

Allahumme biKe asbahna ue biKe emsejna, ue biKe nahja ue biKe nemuutu, ue ilejken-nushuur

“O Allah! Me Lejen T  nde u gdhim   dhe me Lejen T  nde u ngrys  m, me Lejen T  nde jetojm   dhe me Lejen T  nde do t   vdesim, dhe te Ty   sht   kthimi!”⁷

⁶ Transmeton Abdullah ibn Mes’ud – RadijAllahu ‘anhu – se Pejgamberi i Allahut – sal-Allahu ‘alejhi ue sel-lem – n   mbr  mje thoshte: “E arrit  m mbr  mj  n, i gjith   sundimi dhe e gjith   lavdia i takojn   Allahut...” Dhe n   m  ngjes thoshte gjithashtu: “E arrit  m m  ngjesin, i gjith   sundimi dhe e gjith   lavdia i takojn   Allahut...” [Transmeton Muslimi, 2723]

⁷ Transmeton Ebu Hurejrah – RadijAllahu anhu –, i cili thot  : “I D  rguari i Allahut – sal-Allahu alejhi ue sel-lem – i m  sonite shok  t t   tij dhe u thoshte: “N  se e arrin m  ngjesin ndonj  ri prej jush, le t   thot  : “O Allah! Me Lejen T  nde u gdhim   dhe me Lejen T  nde u ngrys  m, me Lejen T  nde jetojm   dhe me Lejen T  nde do t   vdesim dhe te Ty   sht   kthimi!” Dhe n  se e arrin mbr  mj  n le t   thot  : “O Allah me Lejen T  nde u ngrys  m dhe me Lejen T  nde do t   gdhijm  , me Lejen T  nde jetojm   dhe me Lejen T  nde do t   vdesim dhe te Ty   sht   kthimi!”” [Transmeton Bukhari n   El-Edebul-Mufred, 1199 dhe Nesaiu, 10323]

Duaja (8)

اللَّهُمَّ عَالِمُ الْغَيْبِ وَالشَّهَادَةِ، فَاطِرُ السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضِ، رَبُّ كُلِّ شَيْءٍ وَمَلِيكُهُ، أَشْهُدُ أَنْ لَا إِلَهَ إِلَّا
أَنْتَ، أَعُوذُ بِكَ مِنْ شَرِّ نَفْسِي، وَمِنْ شَرِّ الشَّيْطَانِ وَشَرِّكِهِ، وَأَنْ أَقْتَرِفَ عَلَى نَفْسِي سُوءًا، أَوْ أَجْرَهُ
إِلَى مُسْلِمٍ

Allahumme 'Aalimel-gajbi uesh-shehadeh, Fatiros-semauati uel-erd, Rabbe kul-li shej-in ue meliikeh, esh'hedu en la ilahe il-la Ente. E'uudhu biKe min sherri nefsii, ue min sherrish-shejtani ue shirkih, ue en ekterife 'ala nefsii suuen, eu exhurrahu ila muslim.

"O Allah! Ti je Ai që di tē fshehten dhe tē dukshmen, Krijuesi i qiejve dhe i tokës, Zoti i gjithçkaje dhe Sunduesi i tyre, dëshmoj se nuk ka tē adhuruar tjetër me tē drejtë përveç Teje! Kérkoj Mbrojtjen Tënde nga e keqja e vetes time, nga e keqja e shejtanit dhe thirrjes së tij për në shirk. Kérkoj mbrojtjen Tënde që tē mos i bëj dëm vetes time apo ndonjë Muslimani!"⁸

Duaja (9)

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْعَفْوَ وَالْعَافِيَةَ فِي الدُّنْيَا وَالآخِرَةِ، اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ الْعَفْوَ وَالْعَافِيَةَ فِي دِينِي
وَدُنْيَايِ، وَأَهْلِي، وَمَالِي، اللَّهُمَّ اسْتُرْ عَوْرَاتِي ، وَآمِنْ رَوْعَاتِي ، اللَّهُمَّ احْفَظْنِي مِنْ بَيْنِ يَدَيِّ، وَمِنْ
خَلْفِي، وَعَنْ يَمِينِي، وَعَنْ شَمَائِلِي، وَمِنْ فَوْقِي، وَأَعُوذُ بِعَظَمَتِكَ أَنْ أُغْتَالَ مِنْ تَحْتِي

⁸ Transmeton Ebu Hurejrah – RadijAllahu ‘anhu – se Ebu Bekr Es-Siddik – RadijAllahu ‘anhu – tha: O i Dërguari i Allahut! Më urdhëro me disa fjalë që ti them ato në mëngjes dhe në mbrëmje! I Dërguari i Allahut – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – tha: **Thuaj:** "O Allah! Ti je Ai që di tē fshehtat dhe tē dukshmet, Krijuesi i qiejve dhe i tokës, Zoti i gjithçkaje dhe Sunduesi i tyre, dëshmoj se nuk ka tē adhuruar tjetër me tē drejtë përveç Teje! Kérkoj Mbrojtjen Tënde nga e keqja e vetes time, dhe nga e keqja e shejtanit dhe thirrjes së tij për në shirk. Dhe kérkoj mbrojtjen Tënde që tē mos i bëjë dëm vetes time apo ndonjë Muslimani!" Pastaj tha: **Thuaji këto fjalë në mëngjes, në mbrëmje dhe kur të shtrihesh për tē fjetur gjumë.** [Transmeton Tirmidhiu, 3392, 3529 dhe Ebu Daudi, 5067, 5083]

Allahumme inni es-eluKel-'af'ue uel-'aafijete fid-dunja uel-akhirah. Allahumme inni es-eluKel-'af'ue uel-'aafijete fi dijni ue dunjaje ue ehli ue mali. Allahumme-stur 'aurati ue aamin rau'aati. Allahumme-hfedhni min bejni jedejje ue min khalfi, ue 'an jemijni ue 'an shimali, ue min feuki ue e'uudhu bi'adhametiKe en ugtaale min tahti.

"O Allah! Kérkoj faljen dhe shpëtimin Tënd në këtë botë dhe në Botën tjetër! O Allah! Kérkoj faljen dhe mbrojtjen Tënd në Fenë time, dunjanë time, familjen dhe pasurinë time! O Allah! M'i mbulo të metat e mia, dhe më qetëso në momentet trishtuese! O Allah! Më ruaj nga para meje, nga mbrapa meje, nga e djathta ime, nga e majta ime, nga sipër meje dhe kérkoj me Fuqinë Tënde të më ruash që të mos më lëshojë toka!"⁹

Duaja (10)

لَا إِلَهَ إِلَّا اللَّهُ وَحْدَهُ لَا شَرِيكَ لَهُ ، لَهُ الْمُلْكُ وَلَهُ الْحَمْدُ ؛ وَهُوَ عَلَىٰ كُلِّ شَيْءٍ قَدِيرٌ

La ilah il-Allahu uahdeHu la sherijke leH, leHul-mulku ue leHul-hamdu ue Hue ala kul-li shej-in Kadir

"Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, të Vetëm dhe të Pashok, Atij i takon Sundimi dhe Lavdia dhe Ai është Fuqishëm për çdo gjë." ¹⁰

⁹ Transmeton Ibn Umer – RadijAllahu ‘anhuma –, i cili thotë: “I Dërguari i Allahut – sal-Allahu ‘alejhi ue sel-lem – nuk e ka lënë pa bëré asnjëherë këtë lutje në mëngjes dhe në mbrëmje: “O Allah! Kérkoj faljen dhe shpëtimin Tënd në këtë botë dhe në Botën tjetër! O Allah! Kérkoj faljen dhe mbrojtjen Tënd në Fenë time, dunjanë time, familjen dhe pasurinë time! O Allah! M'i mbulo të metat e mia, dhe më qetëso në momentet trishtuese! O Allah! Më ruaj nga para meje, nga mbrapa meje, nga e djathta ime, nga e majta ime, nga sipër meje dhe kérkoj me Fuqinë Tënde të më ruash që të mos më lëshojë toka!”” [Transmeton Ebu Daudi, 5074 dhe Ibn Maxheh, 3871]

¹⁰ Transmeton Ebu ‘Ajash Ez-Zurakij – RadijAllahu ‘anhu – se i Dërguari i Allahut – sal-Allahu ‘alejhi ue sel-lem – ka thënë: “Kush thotë në mëngjes: “Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, të Vetëm dhe të Pashok, Atij i takon Sundimi dhe Lavdia dhe Ai është Fuqishëm për çdo gjë”; ka shpërbirim sa për lirimin e një robi prej bijve të Ismailit (alejhis-selam), i shkruhen dhjetë sevape, i fshihen dhjetë gjynahe, i ngrihen dhjetë grada dhe do të jetë i mbrojtur prej shejtanit deri sa të vijë mbrëmja. Dhe nëse e thotë atë në mbrëmje, do të ketë të njëjtat gjëra deri në mëngjes.”” [Transmeton Ebu Daudi, 5077 dhe Ibn Maxheh, 3867]

Duaja (11)

سُبْحَانَ اللَّهِ وَبِحَمْدِهِ عَدَدَ خَلْقِهِ، وَرِضاً نَفْسِهِ، وَزِنَةَ عَرْشِهِ، وَمِدَادَ كَلِمَاتِهِ

SubhanAllahi ue bihamdiHi ‘adede khalkiHi, ue ridaa nefsiHi, ue zinete ‘arshiHi, ue midade kelimatiHi **(tre herë)**

“I Pastër nga tē metat éshtë Allahu dhe Atij i takon Lavdia; sa numri i krijesave të Tij, sa dëshiron Ai prej robërve të Tij, sa pesha e Arshit të Tij dhe sa pafundësia e Fjalëve të Tij.” ¹¹

Duaja (12)

أَصْبَحْنَا عَلَىٰ فِطْرَةِ الْإِسْلَامِ ، وَعَلَىٰ كَلِمَةِ الْإِخْلَاصِ ، وَعَلَىٰ دِينِ نَبِيِّنَا مُحَمَّدٍ صَلَّى اللَّهُ عَلَيْهِ وَسَلَّمَ ، وَعَلَىٰ مِلَّةِ أَئِيمَنَا إِبْرَاهِيمَ ، حَنِيفًا مُسْلِمًا ، وَمَا كَانَ مِنَ الْمُشْرِكِينَ

Asbahna ‘ala fitratil Islam, ue ‘ala kelimetil Ikhlas, ue ‘ala diini Nebijina Muhammed sal-lAllahu alejhi ue sel-lem, ue ‘ala mil-leti ebijna Ibrahime hanijfen Muslimen ue ma kane minel-mushrikiin.

“E arritëm mëngjesin duke qenë në pastërtinë e Fesë Islame, dhe në fjalën e singertë (La ilahe il-lAllah Muhammed ResulUllah), në Fenë e Pejgamberit tonë Muhammedit – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem –, dhe në Fenë e babait tonë Ibrahimit

¹¹ Transmeton nëna e besimtarëve, Xheurijeh – RadijAllahu ‘anha – se Pejgamberi – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – doli prej dhomës së saj herët në mëngjes për të falur namazin e Sabahut, ndërkohë që ajo ishte në vendin e saj të faljes (duke bërë Dhikr). Pastaj u kthyesh pas lindjes së diellit, dhe ajo ishte përsëri e ulur në atë vend, dhe i tha: “Akoma vazhdon tē jesh në atë gjendje që tē lashë?!” Ajo i tha: Po! Atëherë Pejgamberi – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – i tha: “Me tē vërtetë që kam thënë katër fjalë, tre herë! Nëse do tē përfshiheshin (në peshoren e veprave) me ato lutje që ke bërë ti nga falja e Sabahut deri tani, ato do tē peshonin më shumë! (Ato fjalë janë): “I Pastër nga tē metat éshtë Allahu dhe Atij i takon Lavdia; sa numri i krijesave të Tij, sa dëshiron Ai prej robërve të Tij, sa pesha e Arshit të Tij dhe sa pafundësia e Fjalëve të Tij.”” [Transmeton Muslimi, 2726]

(alejhis-selam), i cili ka qenë larg besimeve të kota, dhe ishte Musliman e nuk ishte prej idhujtarëve.” ¹²

Duaja (13)

اللَّهُمَّ إِنِّي أَسْأَلُكَ عِلْمًا نَافِعًا، وَرِزْقًا طَيِّبًا، وَعَمَالًا مُتَقَبِّلاً

Allahumme innii es'eluKe 'ilmen nafi'an, ue rizkan tajjiben, ue 'amelen mutekabbelen.

“O Allah! Të kërkoj Ty të më furnizosh me dije të dobishme, furnizim të mirë, dhe vepra të pranuara!” ¹³

Përktheu: Servet Mata

¹² Transmeton AbduRahman ibn Ebza – RadijAllahu ‘anhu –, i cili thotë: “I Dërguari i Allahut – sal-IAllahu ‘alejhi ue sel-lem – në mëngjes thoshte: “E arritëm mëngjesin duke qenë në pastërtinë e Fesë Islame, dhe në fjalën e sinqertë (La ilah il-IAllah Muhammed ResulUllah), në Fenë e Pejgamberit tonë Muhammedit – sal-IAllahu ‘alejhi ue sel-lem –, dhe në Fenë e babait tonë Ibrahimit (alejhis-selam), i cili ka qenë larg besimeve të kota, dhe ishte Musliman e nuk ishte prej idhujtarëve.”” [Transmeton Imam Ahmed, 15367]

¹³ Transmeton nëna e besimtarëve Ummu Selemeh – RadijAllahu ‘anha – se Pejgamberi – sal-IAllahu ‘alejhi ue sel-lem – pasi jepte selam në namazin e Sabahut thoshte: “O Allah! Të kërkoj Ty të më furnizosh me dije të dobishme, furnizim të mirë, dhe vepra të pranuara!” [Transmeton Imam Ahmed, 26602 dhe Ibn Maxheh 925]